

Giuseppe Schirò Di Maggio

# Metaforë

vjersha

# Metafora

poesie

3

Poeti del  
Mediterraneo

Salvatore Sciascia Editore

# PROGETTO BRINJAT



Provincia Regionale di Palermo



Comune di  
Contessa Entellina



Comune di  
Mezzojuso



Comune di  
Palazzo Adriano



Comune di  
Piana degli Albanesi



Comune di  
Santa Cristina Gela



Università degli Studi di Palermo  
Facoltà di Scienze della Formazione  
Dipartimento di Scienze filologiche e linguistiche



*Centro Internazionale di Studi Albanesi  
"Rosolino Petrella"*

## Comitato promotore

Francesco Musotto	<i>Presidente della Provincia Regionale di Palermo</i>
Dario Falzone – Maurizio Gambino	<i>Presidente del Consiglio della Provincia Regionale di Palermo</i>
Aldo Messina – Giovan Battista Mammana	<i>Assessore Provincia Regionale di Palermo</i>
Nicola Vernuccio	<i>Assessore Provincia Regionale di Palermo</i>
Pietro Cuccia – Antonino Lala	<i>Sindaco del Comune di Contessa Entellina</i>
Giuseppe Alessi	<i>Sindaco del Comune di Palazzo Adriano</i>
Antonino Di Lorenzo – Gaetano Caramanno	<i>Sindaco del Comune di Piana degli Albanesi</i>
Franco Nuccio – Sandro Miano	<i>Sindaco del Comune di Mezzojuso</i>
Giuseppe Cangelosi	<i>Sindaco del Comune di Santa Cristina Gela</i>
Matteo Mandalà	<i>Facoltà di Scienze della Formazione, Università di Palermo</i>

## Comitato tecnico-organizzativo

Provincia Regionale di Palermo	Assessori Aldo Messina, Nicola Vernuccio, Liboria Di Baudo; Giuseppe Colca, Giovan Battista Mammana <i>Dirigente: Caterina Vegna; Funzionario delegato: Rosalia Prezzemolo</i>
Comune di Contessa Entellina	Pietro Cuccia, Domenico Cuccia; Tiziana Musacchia, Domenico Cuccia
Comune di Mezzojuso	Pietro Di Marco, Antonino Pernicario
Comune di Palazzo Adriano	Giuseppe Alessi, Battista Parrino
Comune di Piana degli Albanesi	Giuseppe Scalia, Pina Ortaggio; Pietro Guzzetta, Giovanni Pecoraro
Comune di Santa Cristina Gela	Giuseppe Cangialosi, Luisa Loffredo
Segretario del Comitato	Pietro Manali
Comune capofila	Comune di Piana degli Albanesi
<i>Coordinatore scientifico</i>	Matteo Mandalà



Giuseppe Schirò Di Maggio

Metaforë  
vjersha

Metafora  
poesie

Salvatore Sciascia Editore

SCHIRÒ DI MAGGIO, Giuseppe

Metaforë vjersha = Metafora poesie / Giuseppe Schirò Di Maggio; nota introduttiva di Matteo Mandalà. – Caltanissetta [etc.] : S. Sciascia. – p. – 21 cm. (Poeti del Mediterraneo ; 3). · Bibliografia dell'autore: p.

I. SCHIRÒ DI MAGGIO GIUSEPPE – Opere poetiche.  
«Metaforë» I. SKJIRÒ MAJI, Zef

II. MANDALÀ, Matteo  
891.991 104 5 ed- CDD20

Scheda catalografica a cura della Biblioteca Comunale "Zef Schirò" di Piana degli Albanesi

## Prefazione

Apparsa nel 1990, *Metafora* è una raccolta pensata e organizzata in risposta – non polemica, ma chiarificatrice – a una serie di tre articoli che, pubblicati da I. C. Fortino tra il gennaio e il febbraio di quell'anno nella rivista letteraria albanese *Drita*, miravano a fissare, come Schirò Di Maggio chiosava nella sua *Premessa* alla prima edizione, «tre tendenze, tre poetiche nella odierna poesia italo-albanese: la prima è riferita alla “etnia come metafora” (poetica di Vorea Ujko); la seconda al “paese come metafora” (poetica di Giuseppe Schirò Di Maggio); la terza alla “terra come metafora” (poetica di Kate Zuccaro)».

Si trattava di «affascinanti teorizzazioni» – così le ha definite ancora Schirò Di Maggio – che risiedevano su una prassi critica che non ho condiviso allora e che continuo a non condividere oggi, perché ritenevo e ritengo, per un verso, pericolosamente deviante l'assunzione *aprioristica* di un sistema tassonomico di valutazione della produzione letteraria di tre autori così diversi e distanti fra loro (per formazione, per interessi, per profondità e, se mi si passa l'ardire, per gusti stile arte e talento) e, per un altro, ingenuamente omologante lo schieramento e, in sede critica, l'abuso di categorie e di parametri che, invece di esaltare la fenomenologia della *differenza* – di quella *potenza del negativo* che è stata croce e delizia della cultura occidentale –, hanno finito per collocare autori e testi in una notte simile a quella che ha reso celebre uno degli aforismi jenesi hegeliani.

Sicché se era vero – come è vero – quel che ribadiva Schirò Di Maggio circa il fatto che le metafore “etnia” e “terra” «non sono che variazioni del medesimo tema che è il “paese”», apparirà il vero significato di quel che l'autore di *Metafora* avrebbe voluto più esplicitamente affermare e che, invece, si è limitato – molto causticamente – ad affidare all'intuizione del lettore ricorrendo all'abile formula retorica del “dico ciò che non vorrei dire” («con ciò non voglio dire che Vorea Ujko, Giuseppe Schirò Di Maggio, Kate Zuccaro cantino alla stessa maniera e siano imprigionati per forza nelle teorizzazioni di cui sopra...»).

Se, dunque, quegli articoli non si riferivano a *tre poetiche*, bensì a tre *varianti* – più o meno evidenti e circoscrivibili – di un'indistinta, identica e, perciò stesso, unilaterale “visione del mondo”, i due risultati che ne conseguivano erano (e lo erano davvero !) piuttosto eccentrici: da un lato, che le opere dei tre autori, filtrate attraverso il setaccio dell'aleatorio tema “etnia-paese-terra”, condividerebbero il medesimo sguardo semiotico – ciò che, oltre ad essere impossibile, è anche *apocalittico* – e, dall'altro, che la letteratura contemporanea italo-albanese altro non sarebbe che un sistema di valori a una dimensione risultante dalla convergenza di punti di vista *integrati* – ciò che, oltre ad essere palesemente falso, non solo si situa ben al di là della pretesa, dichiarata ma non realizzata, di cogliere e descrivere le tendenze poetiche così come le documentano i testi, gli autori e la storia, ma offre di questa letteratura una visione notevolmente deformata.

\* \* \*

La rievocazione dei termini di quella discussione mi è parsa necessaria sia per giustificare al lettore le ragioni che, nel giugno del 1990, hanno stimolato Schirò Di Maggio a comporre le 54 liriche di questo volume, sia per tentare di scongiurare il rischio che queste composizioni vengano interpretate “esclusivamente” dall'angolo visuale che, con meccanica trasposizione, si sarebbe indotti ad assumere sulla base delle suddette suggestioni pre-testuali.

Quelle liriche, in realtà e come l'autore confessa nella citata *Premessa* alla prima edizione, sono state suggerite dalle sensazioni, dai pensieri, dalle constatazioni che Schirò Di Maggio andava annotando durante i numerosi viaggi compiuti nei vari paesi arbëreshë, dalla Sicilia al Molise, oppure dalle letture intense di libri che li descrivevano oppure, ancora, da racconti di amici che li avevano visitati: «dal materiale annotato e dai sentimenti serbati nel cuore» sgorgano pertanto queste poesie.

Il fatto di essere riunite in una raccolta, piuttosto che essere pubblicate in un modo più estemporaneo, non è quindi decisivo perché, è persino ovvio sottolinearlo, quei testi riflettono stati d'animo e pensieri che appartengono a momenti diversi e a suggestioni creative differenti che, proprio in virtù della loro collocazione temporale e della loro forza ispiratrice, suggeriscono un approccio alla lettura meno vincolato all'organicità dell'insieme e più predisposto a valorizzare le peculiarità di ognuna delle liriche.

Naturalmente è presente un *filo rosso* che asseconda il disegno unitario e che Schirò Di Maggio esplicita quando, riferendosi alla "antropizzazione" del "paese" – ma, a questo punto, potremmo riferirci a "centri vitali", *topoi* intesi nel doppio senso di *luoghi letterari* e di *ubi consistam* –, mira a esaltare «la gamma dei sentimenti del mondo, appunto come ce l'ha una persona umana».

Ma, poiché questa sorta di metamorfosi che si compie sotto l'occhio vigile e riflessivo del poeta, deve dar conto anche del fatto che il "paese-persona umana" ha fatto sua «la constatazione di essere o essere stata minoranza etno-linguistica», e che questa presa di coscienza implica una rappresentazione frammentata della propria identità culturale – *qjaku ynë i shprishur*, non a caso dicono di loro gli arbëreshë –, è inevitabile il raggiungimento di un risultato straordinariamente profondo, come lo è quello documentato in *Metafora*, e che possiamo rendere percepibile soltanto per metafora, invitando cioè a intuire, prima, e a condividere, poi, la bellezza unitaria dell'iride in forza della infinita e armonica varietà di colori che la compone.

Non altrimenti si spiegherebbe perché Schirò Di Maggio abbia voluto sollecitare il lettore a trovare in queste poesie “legami contenutistici” con il Kossovo e gli Arbërori di Grecia e l’Albania, che in quanto “geograficamente” lontani dal contesto storico e culturale nel quale sorgono le comunità italo-albanesi, non avrebbero dovuto né potuto essere associati in questa “speciale” rappresentazione della identità arbëreshe. Se ciò è avvenuto è merito esclusivo di una visione meno angusta di quella che intendeva inchiodare la poetica di Schirò Di Maggio alla metafora del “paese”.

\* \* \*

La riedizione di questa raccolta ha un duplice scopo: da un lato, quello di riproporre un *punto di vista* tanto autorevole quanto profondo sull’arcipelago arbëresh a distanza di qualche anno dall’approvazione della legge di tutela della minoranze linguistiche; dall’altro, quello di offrire alla minoranza linguistica italo-albanese e, in particolare a quella che risiede in Sicilia, un solido aggancio alla *Arbëria* continentale nella auspicabile previsione che altri organismi possano ridurre ulteriormente le distanze salvaguardando le differenze. Per il fatto che questo libro rientri nelle pubblicazioni promosse e sostenute nell’ambito del progetto *Brinjat*, costituisce esso stesso un notevole contributo che lascia ben sperare per l’immediato futuro.

Matteo Mandalà

## Hyrje për këtë botim

Kanë shkuar katërbëdhjetë vjet nga botimi me shaptilograf i përmbledhjes poetike “Metaforë”, kushtuar katundet arbëreshë.

Shumë gjëra kanë ndërruar. E pandryshuar ka mbetur dashuria për katundet tanë në tokën italiane. Te viti 1990 shkruajta poezitë në gjuhë më shumë shqipe, sot i ripropozonj në gjuhë më shumë arbëreshe, sipas prirjes, tendencës së kohëvet të sotme, o më mirë të shkrimtarëve e poetëve arbëreshë të sotëm, që privilegjojnë gjuhën arbëreshe si gjuhë që duhet mbrojtur, si na njeh edhe ligji i Parlamentit kombëtar italian. Por, sipas mendimit tim dhe ndjenjës sime, gjuha arbëreshe në nivelin më të lartë dhe më të lëruar, rri shumë afër standardit të sotëm të gjuhës letrare shqipe.

Khuzepe Skiro Di Maxho

Hora e Arbëreshëve, dhjetor 2004.

## Premessa a questa edizione

Sono trascorsi quattordici anni dalla pubblicazione ciclostilata della raccolta di poesie “Metafora”, dedicata ai paesi albanesi.

Molte cose sono cambiate. Inalterato è rimasto l'amore per le nostre contrade in terra italiana. Nell'anno 1990 ho composto le poesie in lingua più che altro schipetara, oggi le ripropongo in lingua tendenzialmente arbëreshe, giusto l'orientamento dei tempi attuali, o meglio degli scrittori e poeti odierni italo-albanesi, che privilegiano la lingua arbëreshe quale lingua da tutelare, come ci riconosce anche la legge del Parlamento nazionale italiano. Ma, a mio parere e a mio sentire, la lingua arbëreshe al suo livello più alto e più raffinato, è molto vicina allo standard linguistico dello shqip letterario.

Giuseppe Schirò Di Maggio

Piana degli Albanesi, dicembre 2004.

## Hyrje

Gjatë turneve të Grupit Teatral "Mondo Albanese" në disa katunde arbëreshe, veja duke shënuar ndijime, mendime, konstatime që më jepnin ato katunde, nga Sicilia gjer në Molize: shënime të tjera merrja, për katundet që nuk njihja drejtpërdrejt, nga leximi i librave që i përshkruanin o nga rrëfimet e miqve që i kishin vizituar. Nga lënda e shënimeve dhe nga ndjenjat e ruajtura në zëmër, del sot kjo përmbledhje vjershash.

Por nuk do të kish dalë kaq shpejt, nëse nuk kish ndodhur një ngjarje me rëndësi të madhe për letrat arbëreshe e shqiptare: botimi i tre artikujve të Italo Kostante Fortinos, profesorit të shkëlqyeshëm të Gjuhës e Letërsisë shqiptare te Universiteti i famshëm "Orientale" në Napoli.

Italo Kostante Fortino është një nga të paktit docentë universitarë të universiteteve tona, por ndoshta është i vetmi, që u kushton studimet e tij edhe "të gjallëve", dua të them se, veç të studiojë veprat e letrarëve tanë të së shkuarës, u kushtohet studimeve të veprave të shkrimtarëve e të poetëve të sotëm arbëreshë. Merita është shumë e madhe!

Prof. Italo Kostante Fortino, në artikujt të dalë te "Drita" - revista e përjavshme letrare artistike - organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë - me datë 14 janar / 28 janar / 11 shkurt 1990, artikuj që i japin themele të forta botës së sotme letrare arbëro-shqiptare, thotë se gjen tri prirje, tri poetika, në poezinë e sotme arbëreshe. E para lidhet me "etninë si metaforë" (poetika e Vorea Ujkos); e dyta me "katundin si metaforë" (poetika e Xhuzepe Skirò Di Maxhios); e treta me "dheun si metaforë" (poetika e Kate Xukaros). Teorizime magjepsëse! Me të cilat në përgjithësi jam i një mendjeje.

Është e qartë se "etnia", ashtu si "dheu", nuk janë gjë tjetër veçse ndryshime të "katundit", që është themeli i vërtetë i forcës arbëreshe, qoftë se ne nuk kemi një unitet administrativ arbëresh më të madh se katundi, qoftë se, që kur s' mbahet mend, çdo katund ka besuar se ka qenë qendra, kërthiza, e gjithë botës arbëreshe, as këtë besim ua ka dorëzuar katundeve të tjera të afërta, më të njohura o më të dendura nga popullsia. Prandaj poezia arbëreshe lidhet vetvetiu me "katundin", që, sipas men-

## Premessa

Durante le tournées in alcuni paesi italo-albanesi fatte con il Gruppo Teatrale Mondo Albanese, andavo annotando sensazioni, pensieri, constatazioni offerte dai paesi arbëreshë, dalla Sicilia al Molise; altre annotazioni prendevo, per i paesi non conosciuti direttamente, da letture di libri che li descrivevano o da racconti di amici che li avevano visitati. Dal materiale annotato e dai sentimenti serbati nel cuore, esce oggi questa raccolta di poesie.

Ma non sarebbe uscita così presto, se non fosse accaduto un fatto importantissimo per le lettere albanesi: la pubblicazione di alcuni articoli di Italo Costante Fortino, chiarissimo professore di Lingua e Letteratura albanese nella prestigiosa Università Orientale di Napoli.

Italo Costante Fortino è uno dei pochissimi docenti universitari delle nostre università, ma forse è il solo, che dedica i suoi studi anche “ai viventi”, voglio dire che, oltre a studiare le opere dei nostri letterati scomparsi, si dedica allo studio delle opere degli scrittori e dei poeti arbëreshë viventi. Grandissimo suo merito!

Il prof. Italo Costante Fortino, negli articoli apparsi su “Drita” - rivista settimanale letteraria e artistica - organo della Lega degli scrittori e artisti d’Albania - del 14 gennaio / 28 gennaio / 11 febbraio 1990, articoli che danno basi solide all’attuale mondo letterario albanese, individua tre tendenze, tre poetiche, nella odierna poesia italo-albanese. La prima è riferita alla “etnia come metafora” (poetica di Vorea Ujko); la seconda al “paese come metafora” (poetica di Giuseppe Schirò Di Maggio); la terza alla “terra come metafora” (poetica di Kate Zuccaro). Affascinanti teorizzazioni! Sulle quali in linea di massima mi trovo d’accordo.

È però evidente che l’“etnia”, così come la “terra”, non sono altro che varianti del “paese”, che è la vera base della forza arbëreshe, sia perché non c’è un’unità amministrativa più grande che ci riguardi, sia perché da sempre ogni paese ha creduto di essere il centro, l’ombelico, dell’universo arbëresh, né questa supposizione l’ha voluta cedere ad altri paesi vicini più conosciuti o più consistenti come popolazione. Quindi la poesia arbëreshe fa

dimi t'im, është ruajtësi i "etnisë" dhe është edhe "dheu" i dukshëm e i gjallë i saj.

Me kaq, s'dua të them se Vorea Ujko, Xhuzepe Skirò Di Maxhio, Kate Xukaro shkruajnë në të njëjtën mënyrë o janë të mbyllur me forcë në teorizimet e lartpërmendura; dua të them se, metaforë për metaforë "etnia" e "dheu" nuk janë gjë tjetër veçse variacione të së njëjtës temë që është "katundi" arbëresh.

Sidoqoftë, duhet t'ia njohim profesorit Italo Kostante Fortinos meritën e madhe t'u shtrojë përpara syve të studiuesve dhe të arbëreshëve përmbajtjet e fuqishme dhe bukurinë a vargjeve të poezisë së sotme arbëreshe, gjë që asnjë profesor universitar tjetër, këtu në Itali, nuk e ka bërë kurrë o nuk e ka bërë me aq mprehtësi të madhe, me aq dashuri të thellë dhe me aq kompetencë. E mbasi dëshiroja t'i bëja nder meritës së tij, desha ta teproja me poetikën e "katundit", duke folur në vargje me/për të gjithë katundet arbëreshe të Italisë, pak a shumë të gjallë o të vdekur para pak kohe (të vdekur për gjuhën tonë!).

Dolën kështu 54 lirika. "Katundi" njerizohet, bëhet "njeri" që ka në vete gjithë shkallën e ndjenjave të botës, pikërisht si i ka një njeri, e më shumë konstatimin se është o ka qenë minoritet etniko-gjuhësor.

Shpresoj se kush do të ketë mundësinë t'i lexojë këto emociione të mia, t'i përvetësojë e t'i rijetojë.

Nuk them se këto poezi, të kushtuara katundeve arbëreshe, kanë lidhje, nga pikëpamja e përmbajtjes, me Kosovën o me Arbërorët e Greqisë, por kush do t'i gjejë ndonjë referim të hollë te ndonjë vjershë, nuk gabon në interpretim. Sepse si mund të shkruajë poezi o proza një arbëresh, pa pasur mendjen të gjithë vendet ku flitet gjuha jonë shqipe-arbëreshe, në Shqipëri natyrisht, në Kosovë, te Arbërorët e Greqisë, e pa pasur në mendje edhe çështjet e tyre?

Xhuzepe Skiro Di Maxhio

Hora e Arbëreshëvet, qershor 1990.

spontaneo riferimento, a mio parere, al “paese”, che è il vero custode dell’etnia” ed è anche la “terra” visibile e viva di essa.

Con ciò, non voglio dire che Vorea Ujko, Giuseppe Schirò Di Maggio, Kate Zuccaro cantino alla stessa maniera o siano imprigionati per forza nelle teorizzazioni di cui sopra; voglio semplicemente dire che, metafora per metafora, l’etnia” e la “terra” non sono che variazioni del medesimo tema che è il “paese” arbëresh.

Comunque sia, bisogna riconoscere a Italo Costante Fortino il grandissimo merito d’aver posto all’attenzione degli studiosi e degli italo-albanesi i validissimi contenuti e la bellezza versificatoria della poesia odierna albanese, cosa che nessun altro professore universitario, qui in Italia, ha mai fatto o ha fatto con così grande perspicacia, con così grande amore e competenza. E siccome volevo render onore al suo merito, ho voluto estremizzare la poetica del “paese”, trattando in versi di tutti i paesi albanesi d’Italia più o meno vivi o morti da poco (morti per la lingua!).

Sono venute fuori così 54 liriche. Il “paese” si “antropizza”, diventa “persona” che ha in sé tutta la gamma dei sentimenti del mondo, appunto come ce l’ha una persona umana, e in più la constatazione di essere o di essere stato minoranza etnico-linguistica.

Spero che le mie emozioni in versi siano recepite e rivissute da chi avrà la possibilità di leggerle.

Non dico che queste poesie, dedicate ai paesi italo-albanesi, abbiano legame, dal punto di vista contenutistico, con il Kossovo o gli Arbërori di Grecia, ma chi vuole trovarvi qualche riferimento in qualche poesia, non sbaglia nell’interpretazione. Perché, come può scrivere poesie o prose in arbëresh senza riferirsi con la mente a tutti i luoghi dove si parla la nostra lingua albanese, all’Albania naturalmente, al Kossovo, agli Arbërori di Grecia, e senza pensare anche ai loro problemi?

Giuseppe Schirò Di Maggio

Piana degli Albanesi, giugno 1990

## **METAFORA \ LA METAFORA**

*Shënim.* Trajtat arbëreshe autori i vuri apostlafat në tekstin e poezivet.  
*Nota.* Le forme arbëreshe sono state inserite volutamente nei testi poetici dall'autore.

- ...ANDALLI \ ANDALI (CZ) ...01
- ...BADHESA \ VILLA BADESSA (PE) ...02
- ...BARILLI \ BARILE (PZ) ...03
- ...ÇERVIKATI \ CERVICATI (CS) ...04
- ...ÇIFTI \ CIVITA (CS) ...05
- ...EJANINA \ EJANINA DI PRASCINETO (CS) ...06
- ...FALLKONARA \ FALCONARA ALBANESE (CS) ...07
- ...FARRNETA \ FARNETA DI CASTROREGIO (CS) ...08
- ...FERMA \ FIRMO (CS) ...09
- ...FIRMOZA \ ACQUAFORMOSA (CS) ... 10
- ...FRASHNITA \ FRASCINETO (CS) ...11
- ...GARAFÀ \ CARAFFA DI CATANZARO (CZ) ...12
- ...HORA E ARBËRESHËVET \ PIANA DEGLI ALBANESE (PA) ...13
- ...KARFICI \ CARFIZZI (CZ) ...14
- ...KASTËRNEXHI \ CASTROREGIO (CS) ... 15
- ...KATUNDI \ GRECI (AV) ...16
- ...KAZALLVEQI \ CASALVECCHIO DI PUGLIA (FG) ...17
- ...KEJVERICI \ CAVALLERIZZO DI CERZETO (CS) ...18
- ...KËMARIMI \ CAMPOMARINO (CB) ...19
- ...KUNTISA \ CONTESSA ENTELLINA (PA) ...20
- ...MAQI \ MACCHIA ALBANESE (CS) ...21
- ...MARÇËDHUZA \ MARCEDUSA (CZ) ...22
- ...MARRI \ MARRI (CS) ...23
- ...MASHQITI \ MASCHITO (PZ) ...24
- ...MBUZATI \ SAN GIORGIO ALBANESE (CS) ...25
- ...MUNGRASANA \ MONGRASSANO (CS) ...26
- ...MUNXIFSI \ MEZZOJUSO (PA) ...27
- ...MUNXHIFUNI \ MONTECILFONE (CB) ...28
- ...PALLACI \ PALAZZO ADRIANO (PA) ...29
- ...PICËLIA \ SANTA CATERINA ALBANESE (CS) ...30
- ...PLLATANI \ PLATACI (CS) ...31
- ...PORTKANUNI \ PORTOCANNONE (CB) ...32
- ...PUHËRIU \ PALLAGORIO (CZ) ...33
- ...QANA \ CERZETO (CS) ...34
- ...QEFTI \ CHIEUTI (PG) ...35
- ...RURI \ URURI (CB) ...36
- ...SËNDASTINA \ SANTA CRISTINA GELA (PA) ...37
- ...SPIXANA \ SPEZZANO ALBANESE (CS) ...38
- ...STRIGARI \ SAN COSMO ALBANESE (CS) ...39
- ...SHËN BENEHDITI \ SAN BENEDETTO ULLANO (CS) ...40
- ...SHËN JAPKU \ SAN GIACOMO DI CERZETO (CS) ...41
- ...SHËN KOLLI \ SAN NICOLA DELL'ALTO (CZ) ...42
- ...SHËN KOSTANDINI \ SAN COSTANTINO ALBANESE (PZ) ...43
- ...SHËN MARXANI \ S. MARZANO DI SAN GIUSEPPE (TA) ...44
- ...SHËN MITRI \ SAM DEMETRIO CORONE (CS) ...45
- ...SHËN MËRTIRI \ SAN MARTINO DI FINITA (CS) ...46
- ...SHËN PALI \ SAN PAOLO ALBANESE (PZ) ...47
- ...SHËN SOFIA \ SANTA SOFIA D'EPIRO (CS) ...48
- ...SHËN VASILI \ SAN BASILE (CS) ...49
- ...UNGRA \ LUNGRO (CS) ...50
- ...VAKARICI \ VACCARIZZO ALBANESE (CS) ...51
- ...VINA \ VENA DI MAIDA (CZ) ...52
- ...XHINËSTRA \ GINESTRA (PZ) ...53

...01

Evropa me mijëra ngjyra  
Evropa e kufijvet të hapur  
Evropa e gjuhëvet  
Evropa e bankavet  
Evropa e së ardhmes  
do të vinjë edhe këtu.  
Mikpritës i përpiktë,  
do të veshësh tët bijë  
me kostumin tradicional  
e do t'ë dërgosh te sheshi kryesor  
me kanistrën më të re  
t'i dhuronjë Evropës  
sa dheu yt prodhon  
vaj verë djathëra.  
S' mund t'i dhuronjë,  
vajza jote e pafajshme,  
shëngun e privilegjit tënd më të vjetër  
fjalën arbëreshe  
të bjerrë dhuratë të shpirtit.

...02

– Mos u nis kaq shpejt, vëlla,  
s' më jep as edhe kohën  
të të shtronj bukë e verë  
të të flas për gjellën time  
për vetminë time e për psenë.  
Mos rrimë këtu te dera.  
Mos u trëmb të hysh.  
E di se mund të t' dukem si trau i sprasëm  
i njëi argshi të vjetër nani mbërthyer  
nga bunaca e pandjeshme  
e këtij oqean-homologimi,  
por çë do t'i bënj? Mundet në realitet  
të bëhet ndonjë gjë?  
Ngushullimi i pranisë sate – u e di –

...01

L'Europa dai mille colori  
l'Europa delle frontiere aperte  
l'Europa delle lingue  
l'Europa delle banche  
l'Europa del futuro  
verrà anche qui.

Ospite attento,  
vestirai tua figlia  
con il costume tradizionale  
e la manderai nella piazza principale  
con il cesto più nuovo  
a offrire all'Europa  
quanto la tua terra produce  
olio vino formaggi.

Non potrà offrirle,  
l'innocente tua figlia,  
il segno più antico della tua distinzione  
la parola arbëreshe  
perduto dono dello spirito.

...02

– Non andar via così presto, fratello,  
non mi dai nemmeno il tempo  
di offrirti pane e vino  
di parlarti della mia vita  
della mia solitudine e del perché.

Non stare alla porta.

Non temere d'entrare.

Lo so che sembro essere l'ultima trave  
di una vecchia zattera ora bloccata  
dalla calma indifferente  
dell'oceano-omologazione,  
ma che posso farci? C'è realisticamente  
qualcosa da fare?

Il conforto della tua presenza – sono certo –

do të më rëndonjë më shumë vetminë  
çë do të pasonjë mënjëherë nisjen tënde.  
Vetmisë pra do t'i shtonj vetmi.  
Zinxhiri im.  
Pastaj më qëndron po të mbyllem në vetvete  
me shoqërinë e pakëndshme  
të regëtimit mekanike të orëvet.

...03

Më delh. Ka gradë alkalike të larta  
kjo mirëpritje jote.  
Gjaku i dheut tënd. Transfuzion.  
U këtë verë të pagëzuar  
me dashuri vëllazërore  
s' e mbanj mirë!  
Tryeza e shtruar. Buka që gjeshe ti  
por lulet e fjalëvet  
kundërmojnë më fort se rigani.  
Qesh. Më thua se sekretin  
e ditëvet të gjata  
e ruan në shpellat e tua  
– barkushe të zëmrës.  
U s' di që të të thom.  
S' mund të flitct me objektivitetin e verës.  
Por dy fjalë duhet t'i vë në tryezë.  
Jam i sigurt se mosgjë e mosnjeri  
mund të të ndërronjë  
gjër që në kurmin tënd do të rjedhënj  
limfa arbëreshe që të përcakton!

...04

E di, mos rri e mërijtur!  
S' ke nevojë të nkuqesh!  
Kjo botë jona s' është  
bota e çudiravet!  
Një ditë të erdhi turp

renderà più dura la mia solitudine  
successiva al tuo partire.  
A solitudine aggiungerò solitudine.  
La mia catena.  
Non mi resta poi che chiudermi in me stessa  
con la compagnia noiosa  
del pulsare meccanico delle ore.

...03

Mi ubriachi. Ha un'alta gradazione alcolica questa tua  
ospitalità.  
Il sangue della tua terra. Transfusione.  
lo questo vino battezzato  
d' amore fraterno  
non lo reggo bene!  
Tavola imbandita. Il pane che hai preparato tu  
ma i fiori delle parole  
profumano più dell'origano.  
Ridi. Mi dici che il segreto  
della tua longevità  
lo nascondi nelle tue grotte  
– ventricoli cardiaci.  
Io non so che dirti.  
È difficile parlare con l'obiettività del vino.  
Ma due parole te le voglio dire.  
Sono certo che niente e nessuno  
ti potrà cambiare  
finché nel tuo corpo cirolerà  
la linfa arbëreshe che ti connota!

...04

Lo so, non ti crucciare!  
Non è il caso di arrossire!  
Questo nostro mondo non è  
il paese delle meraviglie!  
Un giorno ti sei vergognato

për veten tënde e për fjalët e tua  
dhe lype shkurorëzim nga gjuha jote e parë!  
Një perëndi fitimtare veproi mbi tyj shndërrimin  
e sot ke vetëm gjuhën tënde të dytë.  
Mund të mburresh me kaq për ndonjë  
pikë qëndrese:  
ca pleq belbëzojnë edhe sot  
ndonjë shprehje të gjuhës së parë!  
Por rri në pritë – ka qënë përherë në pritë –  
furtuna e tmerrshme e asaj perëndie fitimtare:  
një vrundull më të vendosur  
e as dhe pleqtë do të të qëndrojnë më.  
Por ti mos rri e mërijtur!

...05

Vendose male të gjallë si mure për mbrojtje  
e humnera të pakaptueshme ku me vrull  
rrjedhin ujëra luftëtare pengesa  
kundër hyrjes së armiqvet. Por armiku  
i sotëm televiziv çë s' mundi  
nga dheu të vij, me dhunë hyri  
nga ajri o nëpërmjet kabllës e nani  
është mik i përhershëm i gostivet  
e i festavet të tua. Por kush gërryen pak  
ngjyrën e jashtme të shtëpivet të tua  
zbulon zëmrën tënde të kuqe arbëreshe  
e kush fshin pluhurin nga gurët e tu rrugorë  
ndien kumbimin e vallevet akoma  
për të dashurën tënde të vjetër.

...06

Qëndrove në moshën tënde të re  
dhe as ke nevojë të fshehësh vitet:  
me siguri të ruajti kështu  
dashuria e dëshira e atyre që të vinin rrotull.  
Qëndrove besnike ndaj parimevet të dëlirësisë

di te stesso e delle tue parole  
e hai chiesto divorzio dalla tua prima lingua!  
Un dio vincente operò in te la trasformazione  
e oggi hai soltanto la tua seconda lingua.  
Puoi vantare però qualche  
punto di resistenza:  
alcuni vecchi ancora balbettano  
qualche espressione della prima lingua.  
Ma è in agguato – lo è da sempre –  
il vento temibile di quel dio vincente:  
una sfuriata più decisa  
e nemmeno i vecchi ti resteranno più.  
Ma tu non ti crucciare!

...05

Hai posto montagne vive come mura di difesa  
e fossati invalicabili dove d'impeto  
scorrono acque guerriere ostacolo  
all'accesso dei nemici. Ma il nemico  
odierno televisivo che non potè  
da terra venire, con l'inganno entrò  
dall'etere o via cavo ed è ormai  
ospite fisso dei tuoi banchetti  
e delle tue feste. Ma chi raschia un po'  
la tinta esterna delle tue case vede  
il tuo rosso-cuore arbëresh  
e chi spazza la polvere dalle tue pietre stradali  
ancora sente il risuono delle danze  
per il tuo antico amore.

...06

Sei rimasta alla tua età giovanile  
né hai bisogno di nascondere gli anni;  
di sicuro ti ha conservato così  
l'amore e il desiderio dei tuoi corteggiatori.  
Sei rimasta fedele ai principi di castità,

edhe në kohë në të cilat  
të shkëshillohej të ndodheshe e vetme.  
Mund të vazhdosh ashtu për mot e monë.  
Por trëmbem mos të të paraqitet  
nga rruga kryesore – në një mesditë  
plot me diell të hutuar –  
ndonjë lajkatar magjepsës  
çë të rrëmben me turbomakinën e kuqe-flakë  
- volumin e stereos të gjithë-lart  
çë mbyt thirrrmat e tua të kota.

...07

E di se të jap zymtësi kur të flas  
për sëmundjet e tua  
e se duhet të të vërenjë jatroi  
– një “TAK”, një “check up”, analizë e gjakut  
e urinave dhe e ndo gjëje tjetër –  
se duhet të mbash  
– por e ke mbajtur prej kohësh,  
sidomos kur s’kishe gjë tjetër të mbaje -  
dietën mesdetare  
se duhet të bësh lëvizje  
stresit t’i reshtesh të jetës moderne!  
Ë i rëndë rrëziku  
sepse mund të zhytesh  
në një përjetësi heshtjeje  
ku as edhe heshtja ndihet,  
ti çë ke mundësi të shpëtohesh  
ngase akoma e largët ë fusha  
çë bën të rrafshë çdo gjë çë nget.

...08

Të gjenj të vetme në këtë pyll lisash  
plot me dre nga ankthet çë nata  
të derdh më tepër se çdo nxënësie të mundshme  
e nga vegimet e tmerrshëm çë dita

anche in tempi in cui  
era sconsigliabile trovarsi sola.  
Potresti durare così in eterno.  
Ma ho paura che spunti  
dalla strada principale – in un mezzodi  
carico di sole distratto –  
qualche corteggiatore irresistibile  
che ti rapisca con la sua turbo rossa fiammante  
- lo stereo a tutto volume  
che copre le tue inutili grida.

...07

So di farti immalinconire se ti parlo  
delle tue malattie  
e che dovresti farti visitare dal medico –  
una “TAC”, un “check up”, esami del sangue  
delle urine di non so cos'altro! –  
che dovresti seguire  
– ma l'hai seguita da sempre,  
soprattutto quando non c'era altro da seguire –  
la dieta mediterranea  
che dovresti fare del moto,  
evitare lo stress della vita moderna!  
Il rischio è grave  
perché potresti immergerti  
in un'eternità di silenzio  
dove nemmeno il silenzio si ode,  
tu che potresti salvarti  
perché ancora lontana è la pianura  
che rende livellata ogni cosa che tocca.

...08

Ti trovo sola in questo bosco di querce  
piena di paura per gli incubi che la notte  
ti riversa al di là di ogni tua possibile capienza  
e per gli orridi fantasmi che il giorno

të bën të të kërcejnë përpara.

Më thua me pikëllim se ke bjerrë  
edhe ngërdheshjen e pavullnetshme  
të buzëqeshjes së hidhët.

Brënda pyllit edhe dielli ë i rremë  
dielli që të ndërton shkallë drite

– të çahen te duart nëse i nget -  
e që kurrë s'mund të të ndihmojnë  
të ikësh nga lëmshet e nënpyllit.

Por në vonon akoma princi yt shpëtues  
do t'e gjenjë krejt të ngurosur kurmin-tënd-lis  
me copa veshjeje të ngjitura  
si flamur disfate.

...09

Poeti\* ynë vdiq gjatë rrugëvet shtetërore  
mbi shtroja hekurishtesh të përdredhura  
me vegime jetësh verbuese. Megjithatë  
shpresa o e ardhmja s'mund të ketë  
erë benzine përzier me gjak  
por fryme të mirë njeriu  
që do të të trashëgonjë brez pas brezit  
me të folmen tënde tipike.

\* Poeti Vorea Ujko, papas Domenico Bellizzi, lindur në Frashnitë më 12.6.1918, famullitar  
i Fermës për 46 vjet, vdiq pas një aksidenti automobilistik, në Bari më 24.1.1989.

...10

Horizonti yt detar është Joni  
i pjellë nga ujërat e tua amniotike  
i pagëzuar me lotët e tua  
të fortë kripe.

Mbi ankthin tënd të rindërtuar  
ngrëjthe ballkone të reja të vëzhgoje  
horizontet e kuq prej deti  
që lindja në agim të bie.  
– Kur m'u çajten ujërat

ti fa saltellare dinanzi.

Mi dici con angoscia d'aver perso  
perfino la smorfia involontaria  
del sorriso amaro.

Nel bosco anche il sole è bugiardo  
il sole che ti crea scale di luce  
– ti si frangono tra le mani se le tocchi -  
e che mai ti possono aiutare  
a fuggire dall'intrico del sottobosco.  
Ma se tarderà ancora il tuo principe salvatore  
troverà tutto pietrificato il tuo-corpo-quercia  
con brandelli di vestito attaccati  
come bandiera di sconfitta.

...09

Il nostro poeta\* è morto lungo le strade statali  
su giacigli di ferraglie contorte  
con visioni di mondi allucinati. Però  
la speranza o l'avvenire non può avere  
odore di benzina misto a sangue  
ma di buon fiato umano  
che ti tramanderà di generazione in generazione  
con il tuo tipico idioma.

---

\* Il poeta Vorea Ujko, papas Domenico Bellizzi, nato a Frascineto il 12.6.1918, parroco di Firmo per 46 anni, e morto, dopo un incidente stradale, a Bari il 24.1.1989

...10

Il tuo orizzonte marino è lo Jonio  
partorito dalle acque tue amniotiche  
battezzato dalle tue lacrime  
forti di sale.

Sulla tua ansia ristrutturata  
hai costruito balconi nuovi a scrutare  
gli orizzonti rossi di mare  
che l'oriente all'alba ti porta.  
– Quando mi si ruppero le acque

ish stinë e mesme - më thua -  
e të lindurit e mi shpejt morën  
rrugët e dheshme të mërgimit  
ashtu që sot druanj  
pranverat e vjeshtat stinë  
në të cilat bijvet që më qëndruan  
zakonisht u zgjohen  
dëshira dashurie të jashtme.

...11

Tokë kufitare.  
Shoh se rron  
gjellë të shumta në përzjerje.  
Shoh se si kunj në mish  
ke botën e autorrugëvet  
me flamujt dhe mitet e tyre.  
Botë fitimtare kjo!  
Ndoshta do t'ë paguash me çmim të lartë  
rreshtimin tënd me kohërat.  
Të uronj të mos qëndrosh më vonë  
si plakë e çmendur  
që me ndihmën e duarvet  
u trashëgon gjëravet të pashpirta  
fjali të pakuptueshme  
ndërsa uturima e motorëvet  
e mbulon të tërë  
dhe gjestet e saj duken  
gjuhë shurdhmemeci.  
Ribëj llogaritë, të lutem.

...12

Në pragun e këtyre shtëpive  
të zbardhura me ngyrat e jugut,  
të gjenj ulur  
ndrikull e tërhequr nga fjalët.  
Natyra jote është prej mishi dhe guri  
– guri më i qëndrueshëm se mishi.

era stagione di mezzo - mi dici -  
e i miei nati all'istante presero  
le vie terrestri dell'emigrazione  
cosicché oggi temo  
le primavere e gli autunni stagioni  
in cui ai miei figli rimasti  
di norma si svegliano  
voglie d'amore straniero.

...11

Terra di frontiera.  
Ti vedo vivere  
molte vite in mistura.  
Vedo incuneato nella tua carne  
il mondo delle autostrade  
con i suoi vessilli e i suoi miti.  
Mondo vincente questo!  
Forse pagherai a caro prezzo  
il tuo allineamento coi tempi.  
Ti auguro di non restare alla fine  
come una vecchia pazza  
che con l'aiuto delle mani  
alle cose inanimate tramanda  
oralità incomprensibili  
mentre il rombo dei motori  
la subissa completamente  
e i suoi gesti sembrano  
linguaggio di sordomuto.  
Rifatti i conti, ti prego.

...12

Sull'uscio di queste case  
tinte dei colori del sud,  
ti trovo seduta  
comare interessata ai discorsi.  
La tua natura è di carne e di pietra  
- la pietra più duratura della carne.

Ashtu ke parë e ke ndier  
me qënien tënde prej guri të qëndrueshëm  
e ke vuajtur e pasur gëzime  
me zëmrën tënde mishi  
trashëgim të çdo brezi.

Mishit i nget pasiguria e së tashmes  
gurit qëndresa e këmbëngulja.

Përsiatje nga mësimet e jetës!

Por shpërthejnë papritur

thirrrma lirie;

niprat e tu kthehen nga shkolla

në këtë orë mesdite.

Të uronj t'i shohësh të kthehen

ndonjë ditë e pra përditë

me çantën plot me ushtrime arbëreshë!

...13

– Veprat arkitektonike më të bukura,  
veprat artistike me nam shekullor

... “Sheshi Shën Marko”

“Kambanari i Xhotos”

“Kulla e pjerrët e Pizës”

“Xhokonda e Leonardos”

“Moisiu i Mikelanxhelos”

“Kapela Sistina”...

janë për mua, që s’kam vepra monumentale

t’u nxjerr përpara turistëve,

gjuha ime!

gjuhë e prerë e përçmuar

e ndotur e copëtuar

e thartuar me të mbeturat e shpendëve

si monument i mbajtur keq

e nxjettur me smog

në rrezik të vazhdueshëm të prishet

por megjithatë

vepra ime arkitektonike më e bukur

kryevepra artistike e qytetërimit tim!

Così ne hai viste e sentite  
con il tuo essere pietra duratura  
e ne hai sofferte e gioite  
con il tuo cuore di carne  
eredità di ogni generazione.

Alla carne attribuisce l'incerto presente  
alla pietra la resistenza e la costanza.

Meditazioni dagli insegnamenti della vita!

Ma scoppiano improvvise  
grida di libertà:

i tuoi nipoti tornano da scuola  
in quest'ora meridiana.

Che tu possa vederli tornare  
un giorno e poi per sempre  
con la cartella piena di compiti arbëreshë!

...13

– Le opere architettoniche più belle,  
le opere d'arte di fama secolare

... “Piazza San Marco”

il “Campanile di Giotto”

la “Torre pendente di Pisa”

la “Gioconda di Leonardo”

il “Mosè di Michelangelo”

la “Cappella Sistina”...

sono per me, che non ho opere monumentali  
da presentare ai turisti,

la mia lingua!

lingua tagliata svilita

inquinata spezzettata

inacidita con gli escrementi dei volatili

come monumento trascurato

annerita dallo smog

in pericolo costante di distruzione

ma pur sempre

la mia opera architettonica più bella

il capolavoro d'arte della mia civiltà!

...14

Duart e stinëvet të kanë dhënë formë  
të ngjashme me kohën dhe ti  
të kohës sjell rrudhat e jashtme  
por mban ende shpirtin djalë  
ashtu si përjetësia t'e dha:  
ë kjo vetëdija që s' ke humbur.

Kështu i ke bërë ballë dredhivet të thurura  
nga bijtë e shumtë të kohës: minutat orët ditët  
muajt vitet shekujt. Koha jote armike,  
së cilës gjatë luftimit  
çdoherë i lë një rreckë prej teje!

Por s'ka rëndësi për tyj të mplakurit - kam besë -  
në akoma të duan këta djem e këto vajza  
të dalë somenatë  
nga një lindje e gëzuar pranvere.

...15

Me përrëdinë tënde të dhënë të mundur  
nga breza bastvënësish  
këtu ti mbahe fort në garën e mbijetesës.

Ke lëkurë të trashë të regjur  
nga pesëqind dimra e pesëqind vera.

Po të duash mund t'i bësh ballë edhe  
qytetërimit gërryes të acidevet.

Po të duash mund të dëftosh  
mburojat e tua shekullore: Koroniatët e tu.

Po të duash mund të shpëtohesh  
nga valët herciane eletromagnetike  
të shkurtra të gjata të mesme,  
pa vatur prapa në mesjetë.

Duhet se edhe na të modernizohemi  
me valë herciane eletromagnetike!

Por le të t'e thom hapur:  
sot më jep gëzim të di  
se nimfat arbëreshe s' kanë ikur  
nga pyjet e tua e se akoma  
i ngjeshin ijët me ujërat e përrenjvet.

...14

Mani di stagioni ti hanno modellato  
a somiglianza del tempo e tu  
del tempo porti le rughe esterne  
ma hai ancora spirito fanciullo  
come l'eternità te lo diede:

è questa la coscienza che non hai perso.

Così hai resistito alle manipolazioni tentate  
dai molti figli del tempo: i minuti le ore i giorni  
i mesi gli anni i secoli. Il tuo tempo nemico  
a cui nella lotta

lasci sempre uno sbrendolo di te!

Ma non t'importa della vecchiaia - penso -  
se ancora ti amano questi fanciulli e fanciulle  
usciti stamane  
da un parto gioioso di primavera.

...15

Con il tuo dio dato perdente  
da generazioni di scommettitori  
ancora qui resisti nella gara della sopravvivenza.

Ti sei fatta la pelle dura conciata  
da cinquecento inverni e cinquecento estati.

Volendo puoi resistere perfino  
alla civiltà corrosiva degli acidi.

Volendo puoi mostrare  
i tuoi scudi secolari: i tuoi Coronei.

Volendo puoi salvarti  
dalle onde herziane elettromagnetiche  
corte lunghe medie  
senza sprofondare nel medioevo.

È necessario che anche noi ci modernizziamo  
con onde herziane elettromagnetiche!

Ma lascia che te lo dica apertamente:

oggi mi conforta sapere  
che le tue ninfe arbëreshe non sono fuggite  
dai tuoi boschi ma ancora  
si cingono i fianchi con l'acque dei ruscelli.

...16

– S' të thom për dhëmbët e mi  
të çarë me përkëdhelje të rënda  
– vëri te numri i njëi sasi shekujsh –  
as për torturat për të mohuar shpirtin  
as për shpëlarjen e trurit sa të ndërroja mendje  
as për provat të më shkulinin gjuhën.

Ku mund t'i bëja ballë i bëra ballë;  
ku pat të lëja - natyra ime njeriu  
m'e lejonte - lashë.

Të thom vetëm se në sot mund të t' flas  
me gjuhën që nani dëgjon, do të thotë  
se mbi gjënë më të rëndësishme ng' u nënshtrova:  
mbi të drejtën të kem fjalën time.

...17

Do të zgjohesh  
me të parën qarje të ndërjegjes sate  
e syhapur do të kërkosh  
horizontin tënd të humbur.

Do të vishesh pra me fjalët e tua  
e me ndjenjat e tua do të rindërtosh  
zjarret e mençurisë sate.

Edhe së largu do të duket zgjimi yt.  
Ndoshta do të jesh pastaj në gjëndje  
t'u bësh ballë goditjevet të erës  
– vënë si je përpara syvet të fushës –  
e ndoshta s'do të druash  
përçafimet plot gjumë të revet  
çë vijjnë nga të katër anët e botës.

...18

- Po rri këtu në këtë anë dheu  
shkëndijë e hedhur nga shpërndarja  
e njëi populli të lashtë.

Këtu ngrëjta muret e shtëpisë së re

...16

– Non ti dico dei miei denti  
rotti a suon di pesanti carezze  
– mettili sul conto di un numero di secoli –  
né delle torture per farmi abiurare l'anima  
né del lavaggio del cervello per farmi cambiare mente  
né dei tentativi di strapparmi la lingua.  
Dove ho potuto resistere ho resistito;  
dove ho dovuto cedere - la mia natura umana  
me lo permetteva - ho ceduto.  
Ti dico solo che se oggi ti posso parlare  
con la lingua che ora ascolti, vuol dire  
che sulla cosa più importante non ho mai ceduto:  
sul diritto ad avere la mia parola.

...17

Ti risveglierai  
al primo vagito della tua coscienza  
e ad occhi aperti cercherai  
il tuo orizzonte smarrito.  
Ti vestirai finalmente delle tue parole  
e con i tuoi sentimenti ricostruirai  
i fuochi della tua intelligenza.  
Anche da lontano sarà visibile il tuo risveglio.  
Forse sarai in grado  
di resistere ai colpi di vento  
– esposto come sei agli occhi della pianura –  
e forse non avrai paura  
degli abbracci carichi di sonno delle nubi  
che vengono dai quattro angoli della terra.

...18

- Me ne sto qui in quest'angolo di mondo  
scheggia lanciata dalla dispersione  
di un antico popolo.  
Qui ho innalzato le mura di una nuova casa

e nga e para shkëndijë ndeza një flakë  
që zgjat akoma.

E megjithëse ajo imja  
është vatër e vogël  
duhet t'e dëgjosh festën që shpërthen  
kur gjithë familja përmblihet.

Atëherë shkëndisin  
si xixa të atij zjarri të lashtë  
fjalët tona me tingull aloglot.

...19

- E kisha me mua shpirtin tim  
kur dola nga shtëpia të veja në punë.  
Më pas sa ng' e ndiejta më me vete:  
ndoshta e humba - thashë - po ku!  
Zura fill t'e kërkoja.  
Jo se ish aq i çmuar  
si mund të duket  
por ish një kujtim i atit tim  
çë e kish pasur nga ati i tij,  
me një fjalë e kuptuat se kish arrënë tek u  
brez pas brezit. Fakti ë  
se ng'e kisha më me vete.

Kërkova te fabrika FIAT;  
kontrollova te lokalet publikë;  
vërejta përposh makinavet te vendpushimet;  
te staciona e trenevet. Mosgjë.

Vajta edhe në plazh, por si bën  
t'e gjesh në mes të atij brumi rëre  
të ngridhur njerëzish!

Më jep një shqetësim të hollë të mos e gjenj.  
Hë, mos lozim, thumëni kush m'e mori!

...20

Ke plagë ende të hapura,  
të vetmet rrënime të dukshëm.  
Lëkundjet e tua më të rrezikshëm

e dalla prima scheggia ho acceso una fiamma  
che dura ancora.

E benché il mio  
sia piccolo focolare  
devi sentire la festa che c'è  
quando tutta la famiglia è riunita.

Allora scoppiettano  
come faville di quell'antico fuoco  
i nostri discorsi di sonorità alloglotta.

...19

- L'avevo con me la mia anima  
quando sono uscito di casa per andare al lavoro!  
Poi non me la sono più sentita addosso:  
l'avrò persa - mi sono detto - ma dove!

Ho incominciato a cercarla.

Non è che fosse così preziosa  
come potrei far credere,  
ma era un ricordo di mio padre,  
che l'aveva ricevuto da suo padre  
insomma avete capito che è giunta a me  
di generazione in generazione. Fatto sta  
che non l'avevo più addosso.

Ho cercato in fabbrica alla FIAT;  
ho controllato nei locali pubblici;  
ho guardato sotto le macchine posteggiate;  
alla stazione dei treni. Nulla.

Sono stato perfino in spiaggia, ma come fai  
a trovarla in mezzo a quel pastone di sabbia  
lievitante di bagnanti!

Mi dà una sottile inquietudine non trovarla.  
Su non scherziamo, ditemi chi me l'ha presa!

...20

Hai ferite ancora aperte,  
uniche devastazioni apparenti.  
I tuoi sismi più pericolosi

janë depërtimet e hollë aq të shumtë  
të njëi mënyre të re të eksistencës.

Do të mbaronjë pra  
se, në pleqërinë tënde, bijtë e tu  
do të të mbyllin në institutin “Kujtesë”,  
ku do të kesh të gjithë ngushullimet,  
por jo ndijimin se je e gjallë.

...21

Ti pate nderimin më të madh  
të vëje në jetë Përbërësin  
e arbëreshisë militante.  
Me këtë nderim të madh  
ke rruar, rron e do të rrosh.  
Në pra rreth teje sot  
heshtja rri e fjetur  
të mjafton  
kur ke festë  
të ngrësh flamurin e De Radës tënd  
për të dhënë iluzionin e vazhdimësisë.

...22

Bijë e dashur,  
tuke vërejtur me sy të njomë të huajt,  
të vuri me barrë  
bujku i mirë lëti çë vinte  
nga katundi yt këtu afër. Pastaj u martove  
tuke zgjidhur problemin kryesor të gjellës sate.  
Por tuke kërkuar të kuptohesh me të  
- ë e logjikshme ngase është yt shoq -  
ke filluar edhe të mendosh me trutë e tij.  
Nani kini një mendim të vetëm  
e një mënyrë shprehëse të vetme,  
moj bijë ish-arbëreshe.

sono le tante sottili infiltrazioni  
di un nuovo modo d'essere.

Andrà a finire poi  
che, nella tua vecchiaia, i tuoi figli  
ti chiuderanno nell'istituto "Memoria",  
dove avrai tutti i conforti,  
ma non la sensazione di vivere.

...21

Tu hai avuto il massimo onore  
di aver dato i natali all'Inventore  
dell'albanesità militante.

Di tale massimo onore  
hai vissuto vivi e vivrai.

Se poi attorno a te oggi  
ristagna il silenzio,

ti basta

quando fai festa

alzare il vessillo del tuo De Rada  
per dare l'illusione della continuità.

...22

Figliola cara,

a furia di fare gli occhi dolci agli estranei,

ti sei trovata ingravidata

dell'ottimo bracciante latino

che veniva dal paese vicino al tuo. Poi sposandoti  
hai risolto il problema principale della tua vita.

Ma a furia di farti capire da lui

- è logico: è tuo marito -

hai anche incominciato a pensare con la sua testa.

Ora avete un solo pensiero

e un solo modo per esternarlo,

figliola cara ex-arbëreshe.

...23

– Të jesh ë bukur.  
Të dish se je edhe më bukur.  
Në pra u jam një shënim pa vlerë  
për turistin e ngutshëm o s' gjëndem  
– vëmë – te hartat gjeografike  
o te libri i madh i historisë  
ka rëndësi vetëm për studiuesin  
çë bën hulumtime.  
Më mjafton të paktën  
të jem pjesëz e njëi ideje të madhe  
o e shpirtit tonë të përbashkët  
për t'u ndier plotësuar e i kënaqur.  
Por qëndro e gjegj:  
titujt e mi të eksistencës  
ia lajmëron botës kambana ime bizantine.

...24

Pallatet e tua katrore prej guri mashkull  
pushtet i së shkuarës mbi të tashmen ,  
shtëpitë e tua përdhese prej guri femër,  
larg nga qendra, në heshtje të përditshme  
çë kur të zotët përbrënda i mbyllën  
varfërinë e pra ikën!  
Për problemet e prostatës – pleqëria! –  
për astmën e fjalëvet  
për shkujdesjen e ndërlihdhjevet të brezavet  
për pafuqinë të zgjedësh  
nga aq shumë sëmundje atë më të vogël,  
dinë diçka planet e tu të ndërgjegjes.  
Megjithatë, nga mjegulla  
çë të mbështjell te vjeshtat,  
gjegja një mbrëma të ndizeshin për rrugë  
fjalë arbëreshe si zjarre llumineresh  
të sinjalizojnë identitetin tënd  
çë ende s' ke humbur.

...23

– Esistere è bello.

Sapere di esistere ancora più bello.

Se poi io sia un appunto insignificante  
per il turista frettoloso o sia assente

– mettiamo – dalle carte geografiche

o dal grande libro della storia

dovrebbe importare solo

allo studioso che ricerca.

Mi basta al minimo

essere frazione di una grande idea

o del nostro comune grande spirito

per sentirmi completo e appagato.

Ma fermati e ascolta:

i miei titoli di esistenza

li annuncia al mondo la mia campana bizantina.

...24

I tuoi palazzi quadrati di pietre maschie

potere del passato sul presente,

le tue case a piano terra di pietra femmina,

lontane dal centro, nel silenzio quotidiano

da quando i proprietari vi rinchiusero dentro

l'indigenza e si dettero poi alla fuga!

Dei tuoi problemi prostatici – l'età! –

dell'asma delle parole

dell'incuria dei tuoi rapporti generazionali

dell'impotenza a scegliere

fra tanti malanni quello minore

ne sanno qualcosa i tuoi piani di coscienza.

Tuttavia, dalla bruma

che ti avvolge negli autunni,

ho udito una sera incendiarsi per strada

parole arbëreshe come fuochi di luminarie

a segnalare ancora la tua identità

non ancora perduta.

...25

Lutje të Varibobës\*  
çë ngrëhen nga temjanicat  
e shtëpivet në mbrëmje  
mbledhur me mundim  
një ditë pune tjetër  
gezimi të shihen  
të gjithë bashkë të gjallë  
të pranishëm dhe me frymëmarrje  
në erën e ëmbël të shtëpisë  
njerizuar nga kripa e djersëvet  
bij shoqe shoq  
pleq gjyshër lidhje  
ndërmjet së shkuarës dhe së tashmes  
me ogur të domosdoshëm për të ardhmen  
kjo mbrëmje çë si tjerat  
do të zhduket e thithur nga koha  
më parë se të lënj një rreth  
të dukshëm ankthi  
mbi njeriun çë ndien kohën  
si angështimet e veta  
Virgjër Shën Mëri e Varibobës  
çila kokërr rruzareje  
ë kjo mbrëmje çë bie  
e çilit mister i përket  
ankthi njerëzor i përsëritur  
veçse litanivet  
të njëi të vetmi mister të hidhur  
amin për Varibobën e gjallë  
çë lë gjurmë  
në hirin e mbrëmjes  
amin për Varibobën çë vë  
shpresën në majë të natës  
kapërcyer mundimet  
pasionet dhe frikën e botës  
amin për Varibobën  
poet të këtij parrajsi  
këtu të pranishëm e të ndërlikuar

...25

Preghiera di Variboba\*  
che dai turiboli sale  
delle case la sera  
raccolta a fatica  
un'altra giornata di lavoro  
gioia di vedersi  
tutti insieme vivi  
presenti al respiro  
e al dolce odore della casa  
umanizzata dal sale del sudore  
figli moglie marito  
vecchi nonni legami  
di passato e presente  
con auspicio indispensabile di futuro  
questa sera che come tutte  
sparirà assorbita dal tempo  
prima che lasci un alone  
visibile di angoscia  
sull'essere che sente il tempo  
come i propri acciacchi  
Vergine Maria del Variboba  
quale grano di rosario  
è questa sera che cade  
e a quale mistero appartiene  
l'umana angoscia ripetuta  
se non alle litanie  
di un unico mistero doloroso  
amen per Variboba vivo  
che lascia orme  
sulle ceneri della sera  
amen per Variboba che pone  
la speranza in cima alla notte  
superate tribolazioni  
passioni e paure  
amen per Variboba  
poeta di questo paradiso  
qui presente e complicato

aq të prekshëm e njerëzor  
amin për lutjet e Varibobës  
psherëtima përjetësie  
amin përgjithmonë.

\* Jul Variboba, prift e poet, autor i *Gjellës së Sh. Mëris Virgjër*, lindi në Mbuizat më 1724 (°25) e vdiq në Romë më 1788.

...26

– Edhe pak një urth i padukshëm do të më mbulojë  
e një xhungël rrënjësh të reja  
do të marrënj ushqim edhe nga çatitë.  
Në pyll-homologim do të zhdukem.  
Thomse do të ndihet një dite  
midis gërmadhavet të mia të rizbuluara  
kazmëza e arkeologut që kërkon  
me tingull vdekjeje një shenjë  
për të deshifruar identitetin tim të bjerrë.

...27

E ardhmja e natës agimi. Ti e prite.  
E ardhmja e agimit dita e plotë. Ti e rrove.  
E ardhmja e ditës mbrëmja. Ti u krodhe në të.  
E ardhmja e mbrëmjes nata. Ti me të u përziejte.  
Në ciklin e vazhdueshëm të ndjenjave të tua të ndryshme  
u ndodh – aty për aty pa i vënë re – mungesa  
e njëi agimi e njëi dite e njëi mbrëmjeje e njëi nate:  
një zbrazëti e kujteses!  
Humbe një nga të tre shpirtrat e tu.  
Sot meshon greqisht e dashuron italisht.  
Në librat vetëm rri shkruar si ngjarja ndodhi  
se ti shpirtra pate tre.

...28

Foletë e tua shqiponjash,  
nani me indiferencë lënë  
nën diell o nën stuhi,

così tangibile e umano  
amen per le preghiere di Variboba  
sospiri di eterno  
amen per sempre.

\* Giulio Varibobba, sacerdote e poeta, autore della *Vita di Maria Vergine*, nacque a San Giorgio Albanese (CS) nel 1724 ('25) e morì a Roma nel 1788.

...26

– Fra poco un'edera invisibile mi coprirà  
e una giungla di nuove radici  
trarrà alimento perfino dai tetti.  
Nella foresta-omologazione sparirò.  
Un giorno forse si sentirà  
tra i miei ruderi riscoperti  
la piccozza dell'archeologo cercare  
con suono di morte un segno  
che decifri la mia identità perduta.

...27

Il futuro della notte l'alba. Tu l'attendesti.  
Il futuro dell'alba il giorno pieno. Tu lo vivesti.  
Il futuro del giorno la sera. Tu t'immergesti in lei.  
Il futuro della sera la notte. Tu ti unisti a lei.  
Nel ciclo continuo dei tuoi diversi sentimenti  
capitò – lì per lì inavvertita – l'assenza  
di un'alba di un giorno di una sera di una notte:  
un vuoto di memoria!  
Delle tue tre anime ne perdesti una.  
Oggi fai liturgia in greco e ami in italiano.  
Solo nei libri sta scritto come il fatto avvenne  
che di anime ne avesti tre.

...28

I tuoi nidi d'aquila,  
esposti ora indifferentemente  
al sole o alla tempesta,

mbajnë ende gjurmë të ndërrimit të pendëvet.

Bijtë e tu ktheheshin në fole  
pas fluturimevet të parë ushtrimi. Një ditë  
- e prisje, por jo kaq shpejt –  
u hodhën drejt largësivet.

E di se nxore thirrje,  
se vëzhgove çdo gjë që lëvizte  
përmbi tokat dhe shkëmbinjtë.

Aritmitë e zëmrës sate – më thua –  
për iluzionet optike të papritura!

U kthyen vetëm një parë herë, të ndërruar  
aq sa dukeshin të lindur në fole të tjera,  
dhurata duke prurë të çuditshme.

Largësitë u kishën bërë nani  
grumbull kohe pa kujtesë.

Pastaj midis nesh u vendos nderimi  
që u jepet njerëzvet të huaj.

...29

Të bukura atëherë dhomat e tua  
dhe e bukur gjindja jote e marrë  
nga ato orë të gjalla të pranishme.

Sot rreh një jetë tjetër jo konsekuente  
ndërruar orët, ndryshuar mekanizmat e dhëmbëzuar  
dhe gishtat prej metali që i shënojnë.

Dhomat e tua i shoh akoma këtu, por zëra  
s' gjegjem me timbër arbëresh.

Te ndonjë angonë rri i pluhurosur  
një ndijim i lashtë i njëi rëkimi nga zemra.

...30

– E orës sime të sprasme s' di një gjë:  
nëse do të ndodhë për shkak të sinkopës  
o nëse vdekje me agoni do të kem  
natën ditën mbrëmanet menatnet kushedi!  
Indiferencë Shkujdhesje Ironi tri vajtores

conservano tracce della muta di piume.  
I tuoi nati tornavano al nido  
dopo i primi voli d'esercizio. Un giorno però  
- te l'aspettavi, ma non così all'improvviso -  
si librarono verso le distanze.  
So che inventasti richiami,  
che scrutasti ogni cosa che si muovesse  
al di sopra delle terre e delle rocce.  
Aritmie del tuo cuore - mi dici -  
per le improvvise illusioni visive!  
Ritornarono solo un paio di volte, cambiati  
tanto da sembrare nati in altri nidi,  
portando strani doni.  
Le lontananze erano ormai divenute  
cumuli di tempo senza memoria.  
Poi subentrò il rispetto  
che si deve alle persone estranee.

...29

Belle allora le tue stanze  
e bella la tua gente presa  
da quelle ore vive presenti.  
Oggi pulsa una vita non consequenziale  
cambiate le ore, mutati i meccanismi dentati  
e le dita di metallo che le segnano.  
Le tue stanze sono ancora qui, ma voci  
non odo dal timbro allogeno.  
In qualche ripostiglio sta impolverata  
un'antica sensazione di grido dal cuore.

...30

- Della mia ultima ora non so una cosa:  
se avverrà da sincope  
o se trapasso agonico avrò  
di notte di giorno di sera all'alba chissà!  
Indifferenza Distrazione Ironia tre prefiche

do të më qajnë duke më uruar  
kujtim të përjetshëm!  
Vdekur pra, dhëmbje të vona  
kot do të më kushtonjë  
konferencieri i paguar:  
drejt duhej të vërehej  
në ditët e shëndetit tim të rremë!

...31

Kush mund t'e die në ka lindur qeliza e huaj  
çë do të rritet jashtë mase në kurmin tënd  
duke zgjidhur një çfarëdo vendi të koordinatave  
të tua trupore. Një qelizë e çmendur  
ë e pangopur e ua ngjit të tjerave  
pangopësinë. Më thua se si masë parandaluese  
ke ndjekur rregullat për përdorim të bashkëngjitura  
me lindjen tënde: vend i gurtë,  
krahë të mbrojtur nga një mal,  
nja dy përrenj poshtë në hone,  
horizont i hapur nga njëra anë  
për të mbajtur larg klaustrofobinë  
e për të vërejtur në sy sibiritet në radhë.  
Rregullat për përdorim i ke ndjekur; të mbetet  
të kontrollosh qelizën e prishjes,  
çë mos ta bjerë teknika, për shembull,  
o kundërmimi therës i industrisë  
o larësi i sprasëm hedhur në treg  
o telenovela e ardhme në Tv.

...32

Yjësi e Qerres  
yje të vrapit të saj  
polare e festave të tua  
aftësi gjithë arbëreshe  
të mirret në vendim çdo gjë  
për ta paraqitur në tregun e turizmit  
pa ditur se më se gjithë paguan

mi piangeranno augurandomi  
l'eterno ricordo!  
Defunta poi, tardive doglianze  
inutilmente mi dedicherà  
il conferenziere prezzolato:  
giusto bisognava vedere  
nei giorni di mia presunta salute!

...31

Chi può mai sapere se sia nata la cellula estranea  
che crescerà a dismisura nel tuo corpo  
scegliendo un qualsiasi sito delle tue coordinate  
corporali. Una cellula impazzita  
diventa vorace e contagia di voracità  
le altre. Mi dici che a scopo preventivo  
hai seguito tutte le istruzioni per l'uso  
allegate alla tua nascita: luogo pietroso,  
spalle coperte da monte,  
un paio di torrenti in fondo ai burroni,  
orizzonte aperto da un lato  
per fuggire la claustrofobia  
e per vedere in faccia i sibariti di turno.  
Le istruzioni per l'uso le hai seguite; non ti resta  
che controllare la cellula della dissoluzione,  
che non lo porti la tecnica, per esempio,  
o l'odore acre dell'industria  
o l'ultimo detersivo immesso nel mercato  
o la prossima telenovela della tv.

...32

Costellazione del Carro  
stelle della sua corsa  
polare delle tue feste  
capacità tutta arbëreshe  
di appigliarsi ad ogni cosa  
per presentarla al mercato del turismo  
non sapendo che più di tutto

përdorimi i gjuhës  
çë mban të gjalla zakonet  
e çë brumos edhe ajrin çë thithet.  
E nani do të ulërijmë me gjuhën tonë nxitje  
qevet më të fortë  
sa me qerren e tyre të fluturojnë  
më se fërshëllima e erës e të arrëjnë të parët  
dhe përçuesvet të tyre t'u jipen  
dafinat e fitores, ndërsa një Pindar i ri  
me vargjet e tij me përsosje arbëreshe  
do t'i bëjë të pavdekshëm duke i treguar  
admirimit të pasaardhësve.  
Yjësi e Qerres  
në qiellin e këtij katundi arbëresh.

...33

Ndoshta ë ky vendi  
ku mund të shuhen pasionet,  
ku mund të mbyllen sytë si një pëlhurë  
mbi kronikën e përditshme e dhëlpërinë  
e mund të hapen për t'u lindur si provë  
në një botë jo të sëmurë nga të metat.  
Ndoshta këtu do të harrojmë, sepse të largëta,  
decibelet shqetësues të së tashmes.  
Ndoshta këtu do të marrim  
spontaneitet e do të rikthehemi fëmijë,  
katund i butë për zëmrën e me shqiptim puhie.  
Do të ribëhemi njerëz gati për mbrujtje.  
Por në orën e caktuar, fijeve të ndejtur  
të mbrëmjes katundare  
u vërsulet sigla rrëmbyese e televizionit  
e katundi rimerr lidhjet me jetën.

...34

Do të veshësh petka klinde klinde,  
do të zmadhosh sytë me rimel të fortë,  
do të lyesh buzët me të kuq të ndezur

paga l'uso della lingua  
che mantiene vive le usanze  
e che permea anche l'aria che si respira.  
E ora urleremo con il nostro idioma incitamenti  
ai buoi più forti  
perché col loro carro volino  
più del sibilo del vento e taglino primi  
il traguardo e ai loro conduttori vada  
il lauro della vittoria, e un Pindaro nuovo  
con il suo verso di fattura arbëreshe  
li immortali e li additi  
all'ammirazione dei posteri.  
Costellazione del Carro  
nel cielo di questo paese arbëresh.

...33

Forse è questo il luogo  
che propizia lo stemperarsi delle passioni,  
dove poter chiudere gli occhi come un sipario  
sulla cronaca e sulla furbizia quotidiane  
e riaprirli nel tentativo di nascere  
a un mondo non tarato dall'imperfezione.  
Forse qui dimenticheremo, perché lontani,  
i decibel inquietanti del presente.  
Forse qui acquisteremo  
in spontaneità e torneremo fanciulli,  
paese lieve al cuore e dalla pronuncia di brezza.  
Torneremo ad essere uomini da plasmare.  
Ma all'ora solita, sui fili stesi  
della sera paesana  
si abbatte la sigla implicante della televisione  
e il paese riprende i legami col mondo.

...34

Vestirai abiti a svolazzi,  
ingrandirai gli occhi con un rimmel forte,  
dipingearai di rosso fuoco le labbra

jashtë skajit natyror të të duken më mishtore,  
do të ngjyesh thonjtë e mprehtë – thika dashurie –  
do të vësh në krye një kapelë të çuditshme  
e te këmbët këpucë të lustruara me taka të larta;  
do të dukesh vërtet një magjistare moderne  
gati të bësh një të vetme magji të rëndësishme:  
se njerëzit e tu të bëhen të fortë si Skënderbeu-Supermen  
se njerëzit e tu të dashurojnë gjërat që ti dashuron,  
se njerëzit e tu të flasin gjuhën që ti flet,  
se njerëzit e tu të shkruajnë gjuhën që shkruan ti!  
Por si mund të thyesh konkurrencën  
e magjistarevet pas-moderne  
tepër të specializuara në magji ultra gjumësjellëse?

...35

Të gjej këtu në pragun  
e dritares së këtij deti,  
flokë dheu e gruri, kundërmim dielli,  
e re në lëkurë  
sikur të kishe lindur dje.  
Ashtu përfytyron rini  
as u vë veshin psherëtimavet  
mbi ditët e tua të tashme.  
Në këtë orë të ndryshimit të puhisë  
vjen nga deti Adriatik fladi  
që pak më parë  
ka përkëdhelur mëmën shqiptare të lashtë.  
Pra vishe me mjegull e melankoli.

...36

Dëshiroja të dija  
për hapje-mbylljen tënde të përditshme  
të dyervet e të flegravet  
sy veshë gojë të shtëpivet të tua,  
për orët që ndërrojnë petka  
e shkojnë të shpejta nëpër rrugët,

oltre il bordo naturale perché sembrano più carnose,  
ti tingerai le unghie affilate – coltelli d'amore –  
ti metterai un cappello stravagante in testa  
e scarpe lucide coi tacchi altissimi ai piedi:  
vuoi sembrare una perfetta maga moderna  
pronta a fare una sola importante fattura:  
che i tuoi diventino forti come Skanderbeg-Superman,  
che i tuoi amino le cose che tu ami,  
che i tuoi parlino la lingua che tu parli,  
che i tuoi scrivano la lingua che tu scrivi!  
Ma potrai battere la concorrenza  
delle maghe post-moderne  
superspecializzate in fatture ultra soporifere?

...35

Ti trovo qui sul davanzale  
di questo mare,  
capelli di terra-grano, odore di sole,  
nuova di pelle  
come fossi nata ieri.  
Così fingi giovinezza  
né dai ascolto ai sospiri  
sui tuoi giorni presenti.  
A quest'ora di cambio di brezza  
ti giunge dall'Adriatico il vento  
che da poco  
ha carezzato l'antica madre albanese.  
Poi ti vesti di bruma e di malinconia.

...36

Vorrei sapere  
del tuo quotidiano aprire-chiudere  
porte e battenti  
occhi orecchie bocche delle tue case,  
delle ore che mutano d'abito  
e vanno veloci attraverso le strade,

për ndijimin e pandryshueshëm në ajër  
çë japin ndryshesat e tua të dukshme  
– i dukshëm edhe shpirti yt i pandryshuar -  
e për faktin se çdo gjë çë di për tyj  
ë sikurse t'e dija çë kur s' e mbaj më mend.

...37

U veshe me një emër të hijshëm  
e ke të hijshme dukjen  
kur manteli yt ë qielli  
e shtroja jote bari me pupla.  
Shëndeti yt prandaj  
në vështrimin e parë duket i mirë,  
por mos kërko, jatrua, të palposh  
nyjëza në gjirin e saj o t'e hapësh  
për analiza vaginale:  
sëmundjet e saja do të kenë nani  
të ecur në drejtim të njëanshëm  
në ng'i jipet në transfuzion  
një vullnesë e re.

...38

Përpoqa këtu një vajzë spixaniote  
çë mburrej për rrënjët e saja  
përpara meje që ushqehesha  
me fjalët çë i dilnin nga goja.  
E i thamë së bashku arbërisht  
shprehjet e zakonshme  
se gjaku s'bëhet ujë  
se gjaku ynë ë i shprishur  
se jemi gjithë të njëi gjaku!  
Por u dëshiroja të flisja  
për buzët e saja arbëreshe  
për sytë e saj arbëreshë  
për shtatin e saj të hijshëm arbëresh  
për ecjen e saj arbëreshe

dell'immutabile sensazione nell'aria  
che danno i tuoi cambiamenti visibili  
– visibile anche l'anima tua immutata-  
e del fatto che ogni cosa che so di te  
è come se la sapessi da sempre.

...37

Ti sei vestita di un nome gentile  
e hai gentile l'aspetto  
se il tuo mantello è di cielo  
e il tuo giaciglio di erba piumata.  
La tua salute quindi  
a prima vista sembra buona,  
ma non cercare, medico, di palpare  
noduli nel suo seno o di aprirla  
per analisi vaginali;  
le sue malattie avranno ormai  
un andamento a senso unico  
se non le si trasfonde  
una nuova volontà.

...38

Incontrai qui una giovane spezzanese  
che vantava le sue radici  
davanti a me che mi nutro  
delle parole della sua bocca.  
E insieme le dicemmo in albanese  
le solite espressioni  
che il sangue non si fa acqua  
che il sangue nostro è disperso  
che siamo tutti di uno stesso sangue!  
Ma io volevo parlare  
delle sue labbra arbëreshe  
dei suoi occhi arbëreshë  
del suo fascino arbëresh  
del suo incedere arbëresh

për mendjen për ëndrrat për dëshirat  
për gjithë atë që kish arbëreshe e jo vetëm  
për gjakun tonë të përbashkët  
që edhe nga afër  
na mban njeri-tjetrës larg!

...39

Poezi e Serembes\*  
sy të zez të vajzës  
që përpoqëm me shikimin tonë  
premtim dashurie të përjetshme  
poezi e Serembes  
degë ulliri flamur paqeje  
për këto shtëpi të pangara  
në kujtimin e kujt u nis  
poezi e Serembes  
trëndafil e gjemb të mbledhur së bashku  
simbol i ëmbël e i hidhët i gjellës  
poezi e Serembes  
shëtitore e hijesuar  
faltore ndjese  
për dashuritë e pakëmbyera  
je edhe nani ky katund  
i shpirtit tonë arbëresh  
çast i rruar në një realitet të përpiktë  
me dëshpërim o entuziazme të mënjëhershëm  
poezi e Serembes  
ke marr me vete  
këtë katund të shpirtit  
të dashur e të urryer për sa i jipëj  
e për sa ng' i jipëj ushqim  
lakmimit tënd për horizonte më të gjerë se sa  
mund të të dhuroj një dritare e vetme e hapur  
mbi këtë botë tonë me një përmasë të vetme  
e andaj më mirë Amerika  
zbulimi i njëi dheu të ri – Toka Toka!  
por kush më mirë se ti di

dei pensieri dei sogni dei desideri  
di tutto quel che di arbëresh aveva e non solo  
del nostro identico sangue  
che anche da vicino  
ci tiene lontani l'uno dall'altra!

...39

Poesia del Serembe  
occhi neri della ragazza  
che incontrammo col nostro sguardo  
promessa di eterni amori  
poesia del Serembe  
ramo d'ulivo bandiera di pace  
per queste case rimaste intatte  
nella memoria di chi partì  
poesia del Serembe  
rosa e spina colte insieme  
simbolo dolce-amaro della vita  
poesia del Serembe  
viale ombreggiato  
santuario di perdono  
per gli amori non corrisposti  
sei ancora questo paese  
della nostra anima arbëreshe  
momento vissuto in una precisa realtà  
con disperazione o facili entusiasmi  
poesia del Serembe  
ti sei portato appresso  
questo paese dell'anima  
amato e odiato per quello che dava  
e per quel che non dava di nutrimento  
alla tua smania di orizzonti più ampi di quanto  
potesse offrirti una sola finestra aperta  
sul nostro mondo unidimensionale  
e allora meglio l'America  
scoperta di un nuovo mondo – Terra Terra!  
ma chi meglio di te sa

se zbuluesi ka nevojë  
për Amerika të reja që të zbulohen ngaherë  
e se bota njëpërmasore  
e vendit ku ke lerë  
ë ajo që më se gjithë  
thomse ka nevojë të jetë e zbuluar  
poezi e Serembes  
pa varr ku të këndohen  
si lutje vjershat e tua  
mbi të cilin  
trashëgimtarja e dashurisë sate antike  
vajza me sy të zez  
të vendosë një lule  
e trishtuar nga fati yt i çuditshëm  
shpirt që edhe nani udhëton  
lajmëtar i arbëreshisë.

<sup>8</sup>Zep Serembe, poet (1843/1891).

...40

Përparimi kur arrën tek na ë përparim i pazakontë  
duket se s' është në vendin e tij duket lënë aty  
përpara derës sa m'i vullnetshmi t'e hynjë në shtëpi.  
I shkëlqejnë gjithë pjesët e tija kromatike e s' shihet  
asnjë pikë ndryshku; në e nget të jep një ndijim  
të ftohti e gishtat e tu i lënë një kapuç ngrohtësie.  
Vegël e çuditshme përparimi afër bujkut plak  
fytyrë të rrudhur, duar hardhish sapo të krasitura.  
Send i çuditshëm përparimi afër gruas me xhëllonën  
që nga fëmijëria i fsheh moshën të duket  
e pandryshueshme përballë lodhjes. Çfarë do të bëjnë  
ata me përparimin, në ngë ndodh se u shërben bijvet  
të cilët me siguri nani dinë ç'do të bëhet me të!

...41

Poeti\* yt kërkon poezi nëpër rrugicat  
ku ulur rrinë plakat tuke gjetur

che lo scopritore ha bisogno  
di nuove Americhe sempre da scoprire  
e il mondo unidimensionale  
del tuo luogo natio  
è forse quello che più di tutti  
ha bisogno d'essere scoperto  
poesia del Serembe  
senza tomba dove recitare  
come preghiere i tuoi versi  
sulla quale  
l'erede del tuo amore antico  
fanciulla dagli occhi neri  
deporre un fiore  
immalinconita dal tuo strano destino  
spirito che viaggi ancora  
messaggero di albanesità.

\*Giuseppe Serembe, poeta (1843/1891).

...40

Il progresso quando arriva da noi è progresso atipico  
sembra non essere al suo posto sembra lasciato lì  
alla porta perché il più volenteroso lo introduca in casa.

Brillano tutte le sue parti cromatiche e non si nota  
alcun punto di ruggine; se lo tocchi ti dà una sensazione  
fredda e le tue dita gli lasciano un cappuccio di calore.

Strano arnese il progresso vicino al vecchio bracciante  
faccia rugosa, mani di vite appena potata.

Strano aggeggio il progresso vicino alla donna dalla lunga  
gonna che da quando era piccola le nasconde l'età  
perché sembri inalterabile alla fatica. Che se ne fanno  
loro del progresso, se non fosse che serve ai figli  
che sicuramente ormai sanno che farsene!

...41

Il tuo poeta\* cerca poesia tra i vicoli  
dove sedute stanno le vecchie a inventare

punë femërore për duart e tyre rrënjë ulliri.  
Poeti yt kërkon poezi midis bankavet të shkollës  
ku djemtë e vajzat presin njeriun çë do t'u ndezë  
dritën e mendjes. Poeti yt kërkon poezi  
midis gurëvet me bujqit përqendruar  
t'u japënj fryte fara e njëi dite të plotë pune.  
E fillon pra të ecënj brënda natës  
e dritat e ndezura  
janë sytë e tij përjetë të hapur.  
Poeti yt ë këtu si je ti i gjallë e i përjetshëm  
e shqetësimi i tij ë gjithnjë me tëndin.

\* Poeti Karmel Kandreva (1931 - 1982).

...42

Ç' mund t'i japim na sot kësaj dite  
çë pretendime s'ka, por ë këtu  
se këtu duhet të jetë  
me kufijtë e saj nga një mesnatë në tjetrën  
brënda të çilëve një mundim endet,  
një mendim lëviz, birret një fjalë.  
Na mund të rrimë këtu tuke pritur  
për gjithë orët e saja e asgjë  
do të ndodhë me rëndësi.  
Një ditë si tjerat.  
Ngushullim i dobët të dihet  
se ë gjithmonë një unazë e zinxhirit  
pa të cilin s' mund t'arrëhet  
te evoluimi i së sotmes çë do t' arrënjë nesër.

...43

Krenohe për paraardhësit nga Morea  
sikur të thuash se rrjedh me vijë të drejtë  
nga princërit e Anglisë  
o nga dyert më të shquara  
e fisnikërisë romake.  
Ti, çë s' di as se gjuha jote

impegni femminili per le loro mani radici d'ulivo.

Il tuo poeta cerca poesia tra i banchi di scuola  
dove i ragazzi aspettano chi accenda la luce  
della loro mente. Il tuo poeta cerca poesia  
tra i sassi con i villani intenti a far fruttare  
il seme di tutto un giorno di lavoro.

E poi va girando nella notte  
e i lumi accesi  
sono i suoi occhi eternamente spalancati.

Il tuo poeta è qui come lo sei tu vivo ed eterno  
e la sua inquietudine uguaglia la tua.

---

\*Il poeta Carmelo Candreva (1931 - 1982).

...42

Che cosa possiamo dare noi oggi a questo giorno  
che non ha pretese, ma è qui  
perché qui dev'essere  
con i suoi limiti da una mezzanotte all'altra  
dentro cui gira una pena,  
si muove un pensiero, si perde una parola.  
Noi possiamo stare qui ad attendere  
per tutte le sue ore e nulla  
accadrà di speciale.

Un giorno come un altro.

Magra consolazione sapere  
che è sempre un anello della catena  
senza il quale non si può giungere  
all'evoluzione dell'oggi che giungerà domani.

...43

Vanti antenati dalla Morea  
come se dicessi che discendi in linea diretta  
dai principi d'Inghilterra  
o dalle più illustri casate  
della nobiltà romana.

Tu, che non sai nemmeno che la tua lingua

mund të shkruhet e mund të lexohet,  
ti thua Morea për të më treguar pa ditur  
vendin dhe kohën e Pellasgëvet të lashtë  
bij të drejtpërdrejtë të perëndivët.

E ë këtu ku do t'arrësh:  
do të më bindësh mua se Morea jote e ti  
s' mund të vini veçse nga perënditë!  
Por kë do të habitësh, mik i dashur!  
U plotësisht i bindur jam!

...44

Eliksir fuqie të qëndrueshme jipi  
flatravet të pasigurta të hovit tënd  
eliksir bindjeje të qëndrueshme jipi  
njeriut që do të largonjë dyshimet  
nga sytë e fëmijëvet të tu  
eliksir guximi të qëndrueshëm jipi  
njeriut që do të rrënonjë mure  
ndarëse të brezevet  
sa trashëgimia të shkonjë nga ati në bir  
eliksir jetëgjatësie jipi  
njeriut që do t'i japënj rëndësi shkollës  
sepse lind aty studimi i fjalës  
eliksir përjetësie jipi  
shpirtit tënd të madh arbëresh  
sa të mbanjë të pranishme të shkuarën  
dhe e ardhmja të jetë nga ana e qytetërimit.

...45

Fat i pranishëm në lindjen tënde:  
të ishe atdhe!  
E atdhe qeve për njerëzit që atë kishën bjerrë,  
për njerëzit që deshën  
të mbajnë të pangarë ngjyrën e lirisë,  
që deshën të mbajnë besim  
te stili i lutjes së tyre.

si può scrivere e leggere,  
tu dici Morea per indicarmi senza saperlo  
il sito e il tempo degli antichi Pelasgi  
figli diretti degli dei.

Ed è qui che vuoi arrivare:  
vuoi convincermi che la tua Morea e tu  
non potete che discendere dagli dei!

Ma chi vuoi sorprendere, caro amico!

Io pienamente convinto sono!

...44

Elisir di duratura forza dai  
alle indecise ali dei tuoi slanci  
elisir di duratura certezza dai  
a chi vuol mettere in fuga i dubbi  
dagli occhi dei tuoi bambini  
elisir di duraturo coraggio dai  
a chi vuol distruggere muri  
di divisione generazionale  
perché travasi l'eredità di padre in figlio  
elisir di lunga vita dai  
a chi vuole dare peso alla scuola  
perché lì nasce lo studio della parola  
elisir di eternità dai  
alla tua grande anima arbëreshe  
perché abbia presente il passato  
e il futuro sia dalla parte della civiltà.

...45

Destino che presenziò alla tua nascita:  
essere patria!

E patria lo fosti per chi l'aveva persa,  
per chi volle mantenere  
intatto il colore della libertà,  
per chi volle mantenere fede  
allo stile della sua preghiera.

E do të jesh gjithmonë atdhe  
i së sotmes arbëreshe çë ec,  
nëse në kryeqytetin tënd – Kolegjin –  
restauron përmendoret e së shkuarës sate,  
rihap pinakotekën e miqvet të shquar,  
nxjerr pluhurin  
nga biblioteka e intelektualëve të tyre,  
pikë e palëvizshme për njerëzit çë kanë dëshirë  
për të ardhme e përparim.

...46

Në shkon tek ti një don Kishot arbëresh  
i armatosur me fjalë fluturake  
e me entuziazëm jashtë mase,  
te çili krua do t'ë ftosh të pie?  
Tek ai i realitetit  
sa të zbresënj nga ideali  
e të vërenjë botën me këmbë të ngjitura në dhe  
o te kroi i urtësisë  
sa kali-fantazi i tij  
të zbutet e të bëhet i arsyeshëm  
për disiplinën e frerëvet?  
Don Kishoti do të pie te kroi  
i dashurisë së magjepsur  
e do të çilet me dashuri për Dylqinjat e tua,  
por s' mund t'i dashuronjë;  
do të dashuronjë vetëm fjalët arbëreshe  
çë do të dalin me shqiptim të përpiktë  
nga buzët e ëmbla të tyre!

...47

Rrënohe.  
Edhe pak tek ti do të qëndronjë  
vetëm skeleti i shtëpivet ushqim i varfër  
për myshkun e murevet.  
S' ke mjete për të fituar gjellën.  
S' ke mundësi për të rimarrë frymë.

E sarai sempre patria  
del presente arbëresh che camnina,  
se nella tua capitale – il Collegio –  
restauri i monumenti del tuo passato,  
riapri la pinacoteca dei tuoi ospiti illustri,  
togli la polvere  
dalla biblioteca dei loro intelletti,  
punto fermo per chi ha voglia  
di futuro e di progresso.

...46

Se passa da te un don Chisciotte arbëresh  
armato di parole alate  
e di entusiasmo fuor di misura,  
a quale fontana l'inviterai a bere?  
A quella della realtà  
perché scenda dal suo ideale  
e guardi il mondo coi piedi piantati per terra  
o alla fontana della saggezza  
perché il suo cavallo-fantasia  
si ammansisca e diventi ragionevole  
alla disciplina dei freni?  
Don Chisciotte berrà alla fontana  
dell'amore stregato:  
s'innamorerà delle tue Dulcinee,  
ma non potrà amarle;  
amerà soltanto le parole arbëreshe  
che usciranno con perfetta pronuncia  
dalle loro dolcissime labbra!

...47

Ti dissangui.  
Di te fra poco resterà  
solo l'ossatura delle case alimento scarso  
per il muschio murale.  
Non hai mezzi per inventare la vita.  
Non c'è possibilità di riprendere fiato.

Asnjë perspektivë.  
Bota e cirkut të madh të qytetit rrëmben  
ata pak bij të tu.  
SOS. Komë e thellë.  
Qytetërim s' ka më.

...48

Kjo erë livani  
çë lë pas teje  
këto këngë arbëro-bizantine  
çë ecjen tënde ritmojnë  
këto të veshura pontifikale  
çë kurmin tënd rrethojnë  
me hijesi mbinjerëzore  
më japin drithma nga emocioni  
princeshë lindore.  
Ë e kotë se t'e fsheh:  
u çilem me dashuri për tyj  
për çdo psherëtimë livani  
për çdo ndryshim melurgjie  
për çdo shkëndijim  
të kokrrizavet ari të petrahilit tënd  
princeshë lindore.  
E edhe kur ceremonia do të mbaronjë  
e ti do të vishesh  
me xhins e fanellëz të firmosur  
do të më pëlqesh njësoj  
sepse – t'e thomi e qartë –  
kemi një zëmër antike  
por mendja rri te shekulli i ardhshëm.

...49

- Eja kur vishem dimri e kam rezerva  
e mëlmesë të ndanj me miqtë  
përpara dashurisë së njëi vatre.  
Do të të dhuronj me një frymë

Nessuna prospettiva.  
Il mondo del gran circo cittadino rapisce  
i tuoi pochi figli.  
S.O.S. Coma profondo.  
Inciviltà.

...48

Questo effluvio d'incenso  
che lasci al tuo passare  
questi canti arbëro-bizantini  
che cadenzano il tuo incedere  
questi abiti pontificali  
che il tuo corpo avvolgono  
di sovrumano fascino  
mi danno brividi d'emozione  
principessa d'oriente.  
È inutile nascondere:  
io m'innamoro di te  
ad ogni sospiro d'incenso  
ad ogni variazione melurgica  
ad ogni scintillio  
di pagliuzze d'oro della tua stola  
principessa d'oriente.  
E anche quando la funzione sarà terminata  
e vestirai jeans  
e maglietta firmati  
mi piacerai ugualmente  
perché – parliamoci chiaro –  
abbiamo un cuore antico  
ma la mente sta nel prossimo secolo.

...49

- Vieni quando mi vesto d'inverno e ho riserve  
e companatico da spartire con gli amici  
davanti all'amore di un camino.  
Ti offrirò d'un fiato

horizonte të ngjashëm me frikën  
çë ndoshta shpirti i dendur i livanit  
do të të heqë  
e ndoshta përpara teje midis ikonave  
do të shohësh të vallëzonjë  
lindja e paharruar.

Por mos më bëj pyetje pa takt  
për qënien time të sotme o të nesërme:  
u me siguri di vetëm kush isha dje.

...50

- Rri me duar në kryq te hjeja  
çë ky diell vazhdimisht i javës  
vizaton me shtëpitë: mund të më marrësh  
për njeri të papunë o pensionist  
që s'ka tjetër mundim veç t'i ndërronjë  
vendin karriges të mos bjerë  
hjenë çë mblidhet.

Problemet e mi i shkrinj her' e herë  
në gatishmërinë e kripur të shpirtit tim;  
por s' është të luhet; edhe pak  
do të bënjë hyrjen e tij pontifikale  
Mijëvjeçari i Tretë e u s' dua të rri  
me krahë te muri të vërenj pa interes.

Në pritje, do të vesh xhaketën time më të re  
e në sythin lulja-ime-Skënderbe' prej bronzi  
do të bënjë figurën e saj të mirë.

...51

Punët e vogla të përditshme  
orët e punuara me durim zejtari  
gjestet e lodhjes të zmadhuar  
përpara njëi publiku fëmijësh  
sa sidoqoftë të qëndronjë kujtesë  
– asnjë gjest i arbëreshit  
s' është pa histori –  
tingëllimi i zgjatur i zëravet

orizzonti simili a paure  
che forse l'intensa anima degli incensi  
ti scaccerà  
e forse davanti a te tra le iconi  
vedrai danzare  
l'oriente indimenticato.

Ma non pormi domande indiscrete  
sul mio essere oggi o domani:  
di certo so soltanto chi ero ieri.

...50

- Me ne sto con le mani in mano all'ombra  
che questo sole eternamente feriale  
disegna con le case; mi potresti prendere  
per disoccupato o pensionato  
che altra fatica non ha se non spostare  
la sedia per non perdere  
l'ombra retrattile.

I miei problemi li stempero a volte  
con la sapida prontezza del mio spirito;  
ma c'è poco da scherzare; tra poco  
farà il suo ingresso pontificale  
il Terzo Millennio e non voglio stare  
con le spalle al muro a guardare indifferente.

Nell'attesa indosserò la mia giacca migliore  
e all'occhiello il mio fiore-Scanderbeg di bronzo  
farà bella mostra.

...51

Le piccole azioni quotidiane  
le ore lavorate con pazienza d'artigiano  
i gesti della fatica amplificati  
davanti ad un pubblico bambino  
perché comunque ne resti memoria  
– nessun gesto per l'arbëresh  
è senza storia –  
la sonorità prolungata delle voci

çë vërshojnë në mesditën diellore  
ndijimi absurd  
se gjithë sa dëgjon sheh e nget  
duhet me forcë të zhduken  
sado çë të jenë aq të gjalla aq në shëndet  
e s' di në çilën përmasë  
të gjitha këto mund të përsëriten  
po të vijë rasti të përsëriten,  
të çel në buzë një gaz të çuditshëm  
e i buzëqesh ajrit të bjerrë  
sikur se ky ajër i bjerrë  
të ketë futur ndonjë gjë absurde  
në përbërjen e pamjes plot gjallëri  
çë të rri përpara syvet.

...52

– Më duket se jam si qelq i brishtë  
e se udhetoj në këtë Jugitali  
bashkë me disa tjerë qelqe të brishtë.  
Por imja është brishtësi e dyfishtë:  
kam një arsye të parë, kam një arsye të dytë.  
Jugu im i dyfishtë.  
Të qënit tim prej qelqi ushqehet  
me çdo thërrime drite e të dritës pëson  
humoret e ndryshëm. Ashtu jetoj e rri  
me drenë time delikate,  
sepse mund të shndërrohem në mijëra pasqyra  
të mijëravet diejve të thërrmuar  
sapo rrëzuar përdhe e thyer  
nga një frymë më e vendosur e erës.  
Të brishta kështu edhe shpresat e mia!

...53

– Agimi ngjyrë e pëlhurave të mia të tejdukshme  
më lehet nga duart në gjest dhurate  
me esencën e gjinestrës kulluar nga nata.

che irrompono nel mezzodì solare  
l'assurda sensazione  
che tutto quel che senti che vedi che tocchi  
debba per forza svanire  
pur essendo così vitale così in salute  
e non sapere in quale dimensione  
tutto ciò si potrà ripetere  
se mai si ripeterà  
ti porta sulle labbra un sorriso strano  
e sorridi all'aria persa  
come se quest'aria persa  
abbia inserito qualcosa di assurdo  
nel comporre il quadro pieno di vita  
che ti sta dinanzi.

...52

– Mi sembra d'essere fatta di vetro fragile  
e di viaggiare per questa Suditalia  
in compagnia di tanti altri vetri fragili.  
Ma la mia è doppia fragilità:  
c'è un primo perché, c'è un secondo perché.  
Il mio doppio sud.  
Il mio essere vetro si nutre  
di ogni particella di luce e della luce  
subisce i vari umori. Così vivo e sto  
con la mia delicata paura,  
perché potrei trasformarmi in mille specchi  
di mille soli sminuzzati  
appena buttata a terra e infranta  
da un soffio più deciso di vento.  
Fragili così le mie speranze!

...53

– L'alba colore dei miei diafani veli  
mi nasce dalle mani in offerta  
con l'essenza di ginestra filtrata dalla notte.

Dua ngjyrën e virgjërisë sime,  
por s' di gjer kur mund  
t'u bëj ballë fjalëvet me mjaltë  
të tregtarëvet artikujsh kozmetikë  
çë digjen me dashuri përpara derës sime.  
Moshë ime e vërtetë ë lëkura ime e butë.  
Edhe një përkëdhelje mitare  
lë shenjën e saj.  
Çdo mbrëmje do të mbyll natën gjer në agim  
sa esenca e gjinestrës të mos shpërndahej  
në shkëlqimin akademik të yjevet.

...54

Ju dua toka arbëreshe,  
me dashuri pasioni,  
si më i ndezuri dashnor,  
e megjithëse njoh grimin e zbukurimevet,  
kremrat kundër rrudhëvet,  
duart papritur të mbajtura mirë  
– lënë për pak mënjane  
punët shtëpiake o të aravet –,  
të veshurat sipas modës së sprasme,  
çorapët mëndafshi që hollojnë kofshët  
e fshehin gërvishtjet e kallamishtevet  
o venat blu të ditëvet,  
më rrini mirë edhe kështu  
sepse jini edhe në gjendje të ndezni  
zjarre më të larta se llumineret  
e festavet katundare,  
jini në gjendje të jipni drithma sanguine  
më se darkat spontane në të cilat  
toçitet vera nga dheu në gjak,  
më rrini mirë edhe kështu  
sepse s' do të plakeni kurrë,  
pasi e përjeshtme është rryma juaj jetësore  
dhe aftësia juaj  
për rifitimin e rinisë.

Amo il colore della mia verginità,  
ma non so fino a quando potrò  
resistere alle parole di miele  
dei mercanti di cosmetici  
che spasimano davanti alla mia porta.  
La mia vera età è la mia pelle delicata.  
Anche una carezza innocente  
lascia il suo segno.  
Ogni sera chiuderò la notte fino all'alba  
perché l'essenza di ginestra non si disperda  
nell'accademico brillio delle stelle.

...54

Vi amo contrade arbëreshe,  
di amore passionale,  
come il più acceso degli amanti,  
e benché conosca i trucchi degli imbellettamenti,  
le creme antirughe,  
le mani improvvisamente curate  
– dimentiche per poco  
dei lavori domestici o dei campi –,  
i vestiti all'ultima moda,  
le calze di seta che snelliscono le gambe  
e coprono i graffi delle stoppie  
o le vene blu dei giorni,  
mi state bene anche così.  
perché siete ancora capaci di accendere  
fuochi più alti dei falò  
delle sagre paesane,  
siete capaci di dare brividi sanguigni  
più delle spontanee cene in cui  
si travasa vino dalla terra al sangue,  
mi state bene anche così  
perché non invecchierete mai,  
essendo eterno il vostro fluire vitale  
e la capacità di recupero  
della vostra età giovanile.

Finito di stampare  
nel mese di luglio 2005  
dalla Tipografia Lussografica  
di Caltanissetta

